




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje-gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e dytë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 21.1. 2014 me këtë:

RENDI TË PUNËS

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit
3. Propozim-vendimi për caktimin e numrit të anëtarëve të komiteteve të Kuvendit të Komunës
4. Propozim-vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit.
5. Propozim-vendimi për emërimin e Komisionit statutar dhe akteve tjera normative
6. Propozim vendimi për miratimin e orarit të takimeve të Kuvendit dhe komiteteve të KK-së,
7. Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.5 min

Kryesuesi i Kuvendit
Zijadin Maliqi

Në punimet e seancës së dytë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit,
Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini
Përfaqësuesi për të Drejtat e Njeriut Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i KVRL-së
Mediet

Punimet e Seancës së dytë hapi kryesuesi i Kuvendit, Zijadin Mliqi i cili përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, përfaqësuesit e OSB-së dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

Në vijim të punës së seancës, kryesuesi i Kuvendit kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në seancën e dytë të KK-së.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së

Nga ana e sekretarisë u konstatuar se në punimet e seancës së dytë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Në vazhdim të seancës z. Zijadin Malqi theksoi se të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë marrë materialin për këtë seancë dhe me kohë jeni të njoftuar me rendin e punës dhe nuk ka nevojë të lexohet rendi i punës, por kërkoj që ta aprovoni ose nëse ka ndonjë plotësim ose ndryshim në rend të punës mund të propozoni.

Sahit Abazi- në emër të grupit të anëtarëve të PDK-së, kërkojmë që pika 4 e rendit të punës të hiqet nga rendi i punës së seancës së sotme dhe vihet në rend të punës për ndonjë seancë tjetër. Këtë e kërkojmë, sepse nuk na kanë ardhur me kohë informacionet e duhura përkitazi me ndryshimet që parashihen në Statutin e Komunës.

Ne kemi informacione se ka vetëm nisma që të bëhet ndryshimi i statutit, por cilat janë ato ndryshime nuk i dimë ende, prandaj kërkojmë që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

Zijadin Maliqi – përkitazi me pikën e 4 të rendit të punës për ndryshim dhe plotësim të statutit të Komunës do ta arsyetojë kryetari, por vetë fakti se është bërë tkurrur numri i ulësve në Kuvend (numri i anëtarëve të Kuvendit), nga 41 në 35 është një argument se duhet filluar procedura për ndryshim dhe plotësim të statutit të Komunës.

Sahit Abazi- ne nuk jemi kundër ligjit dhe ndryshimit të Statutit, por dëshirojmë që të informohemi nga kryetari se cilat ndryshime janë paraparë në statut në vija të trash dhe jo në hollësi dhe pas këtyre sqarimeve ne do të deklarojemi për ose kundër kësaj nisme të kryetarit.

Izmi Zeka- unë mendoj se nuk ka qenë e nevojshme të jetë asnjë pikë tjetër e rendit të punës, por vetëm ajo për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit i cili pastaj do ta merr për obligim kryesimin e seancave dhe ta përpilojë rendin e punës. Nuk është kompetencë as anëtarit më të vjetër të Kuvendit dhe as e sekretarisë dhe askujt tjetër për ta përpiluar rendin e punës, por është e drejtë e kryetarit të Komunës dhe kryesuesit të KK-së.

Sot ka qenë desh të jetë vetëm pika e parë, kurse të tjerat të mbesin për seancën e radhës.

Zijadin Maliqi- unë e udhëheq seancën deri në momentin që zgjidhet kryesuesi i Kuvendit, kurse posa të zgjidhet kryesuesi ai e udhëheq seancën, kurse unë ulem në ulësen time, por të japin sqarime edhe kryetari për këtë pikë.

Lutfi Haziri- të nderuar pjesëmarrës në këtë seancë, po theksoj se sot është një ditë tjetër e shënuar në implementimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe unë besoj shumë se anëtarët e Kuvendit, do ta realizojnë angazhimet e veta. Mirëpo sa i përket rendit të punës, po theksoj se qëllimi kryesor është që të funksionalizohet sa më parë KK, zgjedhja e organeve tjera, caktimi i numrit të komiteteve etj. Iniciativa për ndryshimin e statutit ka të bëjë me ndryshimin e gjendjes faktike në Gjilan, sepse MPL e ka dërguar në letër se Gjilani më nuk i ka 41 këshilltarë, por i ka 35 si pasojë e rezultatit zgjedhor. Mirëpo në statut duhet të ketë edhe ndryshime të tjera, do të ketë kufizime, do të ketë ulje të kostos buxhetore, por nuk e prek kalendarin e asamblesë Komunale. Unë mendoj se përveç zgjedhjes së kryesuesit duhet të shfrytëzohet koha maksimalisht në mënyrë që më vonë grupet politike të ulen dhe ta bëjnë përfaqësimin e grupeve politike në komitete dhe

mandej të vazhdojmë për ta bërë ndryshimin e statutit. Nuk ka problem që të thjeshtësohet rendi i punës, por ne duhet të jemi sa më efikas në punët tona.

Sahit Abazi – ne përsëri kërkojmë që pika 4 e rendit të punës të hiqet, sepse kjo pikë nuk është aq e thjeshtë dhe e parëndësishme. Ne kërkojmë sqarime përtej asaj që ka qenë 41 këshilltarë të asamblesë komunale dhe tash janë 35, por nuk u dhanë sqarime se cilat janë ato ndryshime .

Zijanin Maliqi- kemi mirëkuptim në vërejtjet e juaja, prandaj propozoj që të hiqet pika 4 e rendit të punës : Propozim-vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit.
Kush është për aprovim të rendit të punës, pa pikën 4 ?

Aprovohet rendi i punës pa pikën 4: Propozim-vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit, me të gjitha votat e anëtarëve Kuvendit.

2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit

Zijadin Maliqi- të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë marrë doracakun për mënyrën e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit, por një pjesë e anëtarëve i dinë mirë rregullat, por unë përsëri po e lexoj nenin i cili e rregullon këtë procedurë, por unë po e lexoj ligjin për këtë çështje me qëllim që të jeni sa më mirë të informuar.

Zgjedhjen e kryesuesit e rregullon neni 41 i ligjit, nr. 3- L/40 për LVL. Në vijim të fjalës së tij z. Maliqi i lexon disa paragrafë të këtij neni.

Mirëpo para se të fillojmë me propozime, së pari duhet ta zgjedhim një komision për ta udhëhequr procedurën e votimit prej 3 ose 5 anëtarëve. Unë propozoj që komisioni të jetë i përbërë prej 3 anëtarëve, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është që komisioni të jetë i përbërë prej 3 anëtarëve? Sipas ligjit votimi është i fshehur.

Aprovohet propozimi që komisioni të jetë i përbërë prej tre anëtarëve,

Në komision për udhëheqje të procedurës së votimeve u propozuan:

1. Imet Rrahmani nga LDK
2. Adelinë Berisha- AAK
3. Arjetë Rexhepi- LVV

Grupi kuvendar i PDK-së nuk propozoi kandidat për këtë komision.

Aprovohet ky propozim me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit.

Zijanin Maliqi- pas u zgjodh komisioni për udhëheqjen e procedurës së votim për kryesues të Kuvendit, kërkoj që t'i propozoni kandidatët ose kandidatin për kryesues të kuvendit.

Abdyl Aliu- në emër të grupit të LDK-së, anëtarëve të Kuvendit të zgjedhur nga vota e popullit i uroj punë të mbarë, kurse në emër të kësaj partie propozoj që zonja Valentina Bunjaku- Rexhepi të kandidohet për kryesuese të Kuvendit. Me këtë propozim ne e

plotësojmë edhe kriterin gjinor, por zonja Valentinë dhe përgatitja e saj profesionale janë në harmoni të plotë dhe me përgjegjësi për të qenë kryesuese e Kuvendit.

Grupet e tjera politike nuk patën propozime.

Selami Xhemajli- ne nuk do të propozojmë kandidatë nga AAK-ja, por po e njoftoj Kuvendin se ne e përkrahim kandidatin e LDK-së në parim, në mënyrë që Kuvendi të jetë funksional dhe të merren vendime në të mirë të qytetarëve. Do të thotë ne nuk do të jemi bllokuese, prandaj në parim e përkrahim kandidaten e LDK-së.

Pas këtij propozimi, anëtarë e Komisionit i përgatisin fletëvotimet, kurse anëtarët e kuvendit shkojnë në pushim 5 minuta.

Pas pushimit prej pesë minutave fillon procedura e votimi, kurse pas votimit, Komisioni konstatoi se në kuti të votimit ishin ; 27 fletëvotime, 4 të pavlefshme, 11 abstenime dhe 23 fletë votime ishin për Valentinë Bunjkun –Rexhepi që të jetë kryesuese e Kuvendit.

Pas kësaj procedure, z. Zijadin Maliqi i uron suksese dhe punë të mbarë zonjës Valentinë dhe e thërret për ta udhëhequr seancën e Kuvendit.

Valentinë Bujaku – Rexhepi – në fillim të fjalës së saj zonja Valentinë e përshëndet kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, anëtarët e Kuvendit për të cilët shpreh falënderime për besimin e dhënë që të jetë kryesuese e Kuvendit. Unë paraprakisht kërkoj falje për ndonjë lëshim eventual, sepse kjo është përvoja ime e parë politike në pozicionin udhëheqës të ndonjë institucioni. Besoj dhe shpresoj se do të keni mirëkuptim dhe së bashku do t' i mbrojmë dhe punojmë për interesat e qytetarëve në mënyrën më të dinjitetshme dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ju faleminderit edhe njëherë për këtë besim që më dhatë sot.

3. Propozim-vendimi për caktimin e numrit të anëtarëve të komiteteve të Kuvendit të Komunës

Valentinë Rexhepi – Bunjaku – ju në materialet e juaja i keni të dhënat për numrin e komiteteve e të cilat gjithsej janë 9 komitete. Komiteti kryesor është Komiteti për Politikë dhe Financa i cili përbëhet prej nëntë anëtarëve të cilët duhet të zgjidhen sipas fuqisë politike të grupeve kuvendare. LDK në KPF i ka 3 anëtarë, PDK 2, AAK1, LVV 1 dhe grupet e tjera i kanë 2 anëtarë.

Komiteti për Komunitete i ka 7 anëtarë, të cilët anëtarë do të zgjidhen më vonë.

Komiteti për Shëndetësi i ka 7 anëtarë, LDK-2, PDK-2, AAK-1, LVV-1 dhe të tjerat grupe 1 anëtarë.

Komiteti për Arsimit i ka 7 anëtarë gjithsejtë .

Komiteti për PUMM, 7 anëtarë.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik 7 anëtarë

Komiteti për SHPKMSH 7 anëtarë

Komiteti për Kulturë, Rini dhe sport 7 anëtarë dhe

Komiteti për Pronë, Kadastër dhe Rindërtim 7 anëtarë.

Izmi Zeka- unë e përgëzoj kryesuesen e Kuvendit dhe uroj suksese dhe punë të mbarë, kurse sa i përket rendit të punës po theksoj se sot si hap i parë është që të përcaktohem

për numrin e komiteteve, sepse më parë ka pasur më shumë komitete, kurse tash numri është reduktuar, prandaj sot duhet të votohet vetëm numri i komiteteve.

Riad Rashiti- suksese kryesuese, përshëndetje për anëtarët e Kuvendit, por fillimisht po i shtoj një pyetje kryetarit të Komunës. Nëse kryetari e ka të planifikuar që të propozoj në seancën e ardhshme ndryshimet në Statut të Komunës, lidhur me reduktimin drejtorive është mirë që mos të formohen ato komitete për të cilat mendohet të bëhet reduktimi i drejtorive.

Lutfi Haziri- unë e falënderoj z. Rashti i cili e ngriti këtë çështje, por ne duhet t' i themelohet komitetet e veçanta, por me konsultimet e mëvonshme dhe me iniciativën që është ndërmarrë tash do të debatojmë për nevojën e rishikimit dhe për nevojën e riorganizimit të komiteteve e që përfshin edhe nevojën e organizimit të një komiteti të veçantë për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje i cili do të merret me projekte të bashkëpunimit ndërkufitar dhe programe të tjera.

Unë mendoj se tash jemi në një qëllim të përbashkët, sot e miratojmë formalisht, e miratojmë orarin formalisht dhe nga seanca e ardhme grupet politike duhet të ulen dhe punojnë bashkë, por edhe me Zyrën e Kuvendit, në mënyrë që ta përgatisin seancën dhe për ta funksionalizuar në tërësi duke përfshirë edhe iniciativën për ndryshimin e Statutit.

Riad Rashti- unë propozoj që sot mos të ngutemi për ta miratuar numrin e komiteteve, por të shkojmë në propozim për dy komitetet obligative si janë KPF dhe atë për Komunitete, kurse të tjerat t' i propozojmë pas miratimit të Statutit. Për nuk është në rregull që sot ta funksionalizojmë një komitet, kurse pas një kohe ta ndryshojmë ose anulohet.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- ne po e votojmë sot numrin e komiteteve, sepse ndryshimi i statutit kërkon kohë, por në çastin që bëhet ndryshimi Statutit, atëherë do të shikojmë se sa komitete do të na nevojiten.

Të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës 3 të rendit të punës?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim-vendimi për caktimin e numrit të anëtarëve të komiteteve të Kuvendit të Komunës, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte kundër, të tjerët abstenuan.

5 Propozim-vendimi për emërimin e Komisionit statutar dhe akteve tjera normative

Valentinë Bunjkau- Rexhepi –pasi që do të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i statutit, është e nevojshme që të formohet një komision për hartimin, plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative i cili do të ketë mandat deri në fund të këtij mandati qeverisës. Komisioni do t' i ketë 5 anëtarë, kurse emrat i sillmi në seancën e radhës dhe atë sipas fuqisë së votës në Kuvend.

Kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës: Propozim-vendimi për emërimin e Komisionit statutar dhe akteve tjera normative, me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

6. Propozim vendimi për miratimin e orarit të takimeve të Kuvendit dhe komiteteve të KK-së

Fehmi Sylejmani – ne si grup politikë kërkojmë që seancat, por edhe komitetet të mbahen në një ditë të caktuar dhe jo në formë rrotacioni. Ne këtë e kërkojmë, sepse shumica jemi punëtorë të arsimit dhe shëndetësisë, prandaj ne i humbim orët e mësimit kur të mbahen seancat e Kuvendit dhe takimet e komiteteve. Është mirë që seancat të mbahen në një ditë të caktuar në mënyrë që ne ta rregullojmë orarin për mos t' i humbur orët e mësimit.

Bujar Nevzadi- e shfrytëzoj rastin që ta përshëndes kryesuesen e Kuvendit dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit, por po deklaroj se për vendimet e drejta dhe konstruktive gjithherë do ta keni edhe përkrahjen e grupit të PDK-së.

Unë pajtohem me atë që tha z.Fehmiu, sepse unë i kam shkuar ditët kur do të mbahen seancat dhe shumica e seancave janë paraparë ditëve të premte, 6 seanca janë ditëve të premte dhe 5 janë ditëve të tjera. Është mirë që dita e premte të jetë ditë për mbajtje të seancave të KK-së, sepse në të kaluarën kemi humbur mjaft orë. Për këtë edhe unë kërkoj që të jetë një ditë e caktuar për seanca, mandej drejtori i Arsimit së bashku me drejtorët e shkollave ta përshtati orarin për arsimtarët që janë anëtarë të Kuvendit.

Lutfi Haziri- duhet bërë një orar të seancave në parim. Unë jam për një ditë, por edhe komitetet obligative t' i kenë ditët e veta të punës. Unë jam për ta harmonizuar dhe për ta përshtat me kërkesat e anëtarëve të Kuvendit.

Sadri Arifi- agjenda e krijuar në këtë mënyrë është për shkak se duhet krijuar një distancë adekuate në mes të KPF-së dhe seancës së Kuvendit. Neve na duhet kohë e mjaftueshme për ta përgatit materialin për Kuvend. Ne do të bëjmë përpjekje për ta plotësuar këtë kërkesë aq sa ka mundësi dhe do të koncentrohemi vetëm ditëve të enjte.

Arben Maliqi- urime për kryesuesen i uroj suksese dhe shëndet me dëshirë që të jetë e suksesshme në këtë post. E përshëndes kryetarin Komunes, por në veçanti i përshëndes subjektet e reja të cilat të cilat janë pjesë e Kuvendit në këtë mandat.

Sa i përket propozimit për mbajtje të mbledhjeve të komiteteve, unë nuk pajtohem që të jetë vetëm një ditë, arsyeje është se ne punëtorët e arsimit çdo herë të enjteve i mbajmë këto takime, atëherë çdo herë do t' i humbim orët në të njëjtën klasë.

Kjo t' i mbetet sekretarisë dhe orari i komiteteve ta ketë një rotacion, sepse nuk kemi mundësi t' i mbajmë orët, por ta kenë parasysh drejtorët e shkollave që ta bëjnë zëvendësimin.

Nevzad Isufi- këtu është fjala për seancat e Kuvendit dhe nuk është fjala për komitete, sepse komitetet kanë numër më të vogël të anëtarëve dhe mund të bëhet harmonizimi i orarit, kurse ne duhet të marrim vendim për seanca të Kuvendit. Seancat e Kuvendit zgjasin shumë dhe është vështirë të bëhet zëvendësimi i orëve.

Abdyl Aliu- në Kuvend përveç punëtorëve të arsimit ka edhe anëtarë të profesioneve të tjera, prandaj po të fillojmë kështu të gjithë humbim diçka. Unë mendoj se kjo çështje t' i mbetet kryesueses dhe sekretarisë dhe mund të vazhdojmë me punë.

Fehmi Sylejmani- nuk krahasohen punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë me punëtorët e tjerë dhe këtë e argumentoi shumë mirë edhe ish drejtori i Arsimit. Ne kërkojmë ta dimë që në fillim nëse seancat mbahen të premten ose të enjteve ne e përshtatim orarin dhe në

këtë mënyrë nuk do të humbën orët. Ne këtë po kërkojmë për shkak të përkushtimit që e kemi në punë për arsimim të fëmijëve tanë.

Ne nuk dëshirojmë që të humbim orë të mësimit, nuk ka rëndësi a humbin orët me leje apo pa leje, por duhet që të angazhohemi që mos të humbim orë. Nuk keni arsyeje që mos ta pranoni këtë propozim, sepse është në dobi të nxënësve.

Selami Xhemajli - së pari e uroj kryesuesen dhe i uroj punë të mbarë, por fillimisht kërkoj që të ketë kujdes dhe mos të bëjnë shkelje, sepse dy tri herë u tejkalova edhe pse kërkoja fjalën më parë. Ne si grup e mbështesim agjendën e propozuar nga sekretaria e Kuvendit, sepse ne këtu kemi ardhur për të punuar Kuvendi dhe për të qenë Kuvendi funksional dhe besoj se sekretaria e ka analizuar më mirë punën edhe të Kuvendit dhe të komiteteve .

Ne e mbështesim propozimin e sekretarisë dhe propozoj që të votojmë për atë version.

Zijadin Maliqi- ky është një orar orientues dhe nuk është fiks dhe është shumë problem për t' i caktuar datat sot për tërë vitin. Këto do të caktohen në bashkëpunim me shefat e grupeve të cilët e shikojnë mundësinë më të mirë për të mos humbur ditë të punës (orë të mësimit).

Valentinë Bunjaku – Rexhepi - nesër të takohen shefat e grupeve në ora 10 dhe të bisedojnë për orarin, kurse sot në parim kërkoj që ta votoni këtë orar të propozuar.

Kush është për aprovim të pikës 6 të rendit të punës.

Aprovohet pika 6 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e orarit të takimeve të Kuvendit dhe komiteteve të KK-së me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

7. Të ndryshme

Sadri Arifi- të gjithë anëtarët e Kuvendit, i kanë marrë formularët për deklaram të pasurisë, por disa anëtarë ende nuk e kanë kthyer formularin në sekretari, prandaj nesër deri në fund të orarit të na e sillni formularin të plotësuar në mënyrë që ne më 23 janar t' i dorëzojmë në Agjensionin Kundër Korrupsionit.

Çështja tjetër të cilën dëshiroj t' ia kujtoj ish anëtarëve të Kuvendit është ajo e kthimit të llap-topëve, të cilën urdhëresë e ka bërë ish kryetari i Komunës.

Fehmi Sylejmani- ne e aprovuan orarin e seancave, por ne kërkojmë që të bëhet transmetimi i çdo seance përmes TV-së lokale “Vali” dhe radiove të tjera, sepse në këtë mënyrë secili qytetarë mund ta përcjell se si po zhvillohen punimet e Kuvendit.

Me këto pika të rendit të punës seanca e dytë në ora 11.45 min i përfundoi punimet.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku – Rexhepi